REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA

DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1936
Datë:08.12.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021

1. **SHFMU "7 Marsi" në Suharekë**
   - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (për kohë të caktuar).
   - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe (për kohë të caktuar).
2. **SHFMU Ismet Jashari-Kumanova" në Javor**
   - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (për kohë të caktuar).
3. **SHFMU "Naum Veqilharxhi" në Mohlan**
   - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (për kohë të caktuar).
   - Një punëtor-e teknik/ndihmës (për kohë të caktuar).
4. **SHFMU "Rilindja" në Nëpërbisht**
   - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
5. **SHFMU " Besim Ndrecaj " në Maqitevë**
   - Një mësimdhënës/e për mësim klasor.(zavendësim i pushimt të lehonisë)
6. **Qerdhja e fëmijëve "Fluturu" në Suharekë**
   - Katër edukatore për punktet në Gjinoc dhe Sopijë (për kohë të caktuar).

Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.10/2018.

Dokumentacioni i nevojshem për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje) e vertetuar tek noteri.
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara të vertetuara nga noteri, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurrimit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Për orarin e testimit me shkrim dhe intërvistimit me gojë do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtori i DKA-së
Ramiz Bajselmani